



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike e OJQ-ve, për personat me nevoja të veçanta për projekte/programme në fushata: avokuese dhe lobuese për avancimin e pozitës së personave me nevoja të veçanta në shoqëri, ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe këshillimeve psiko-sociale, programe/projekte për përkujdesje dhe trajtim të personave me nevoja të veçanta, aktivitetet lidhur me shërbimet e rehabilitimit, socializimit si dhe fushave tjera të ngjashme, ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit 75521.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
 - 1.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 - 1.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit

- 2.3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit(nëse është e aplikueshme)
 - 2.5 Forma e deklaratës së programeve/projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike
 - 2.6 Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur e programin /projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit/projektit
 - 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin/programin
 - 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit/projektit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

- 1.Përfituesit me projekt/programet e tyre do të njoftohen për kohën e nënshkrimit të kontratave
- 2.Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-024/01-0019450/21
Podujevë, 01 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes Thirrjes publike të dt. 10.02.2021, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-KLUBEVE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-Klubeve Sportive, për financimin publik të programeve/projekteve sipas Thirrjes publike në fushën e aktiviteteve sportive publikuar më 10.02.2021, themelohet komisioni në përbërje:

- | | |
|--------------------|---|
| 1. Emin Ajvazi, | kryesues, shoqëria civile |
| 2. Nar Statovci, | anëtar, shoqëria civile |
| 3. Vedat Muçolli, | anëtar, zyrtar për Sport- Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit |
| 4. Haxhere Ajvazi, | anëtare, shefe e thesarit - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave |
| 5. Ardonis Jusufi, | anëtar, zyrtar i të hyrave financiare- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave |

z. Agim Idrizi, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
Arkivit

Nr. 02-020/04-0020084/21
Podujevë, 02 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes Thirrjes publike të dt. 10.02.2021, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-VE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE RINORE/KULTURORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ- për organizimin e aktiviteteve rinore/kulturore, për financimin publik të programeve/projekteve sipas Thirrjes publike në fushën e aktiviteteve sportive publikuar më 10.02.2021, themelohet komisioni në përbërje:

- | | |
|--------------------|--|
| 1.Mehmet Breznica, | kryesues, shoqëria civile |
| 2.Fatmir Halimi, | anëtar, shoqëria civile |
| 3.Xheladin Çitaku, | anëtar, zyrtar për arkivl- Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit |
| 4. Haxhere Ajvazi, | anëtare, shefe e thesarit- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave |
| 5.Ardonis Jusufi, | anëtar, zyrtar i të hyrave financiare - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave |

z.Agim Idrizi, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
Arkivit

Nr. 02-020/04-0020081/21
Podujevë, 02 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja k) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokalen nr.03/L-040, neneve 42 parag. 8 dhe 44 parag.2 të Rregullores (QRK) nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riadhesuar dhe neneve 16, 19 parag.1.11 dhe 61 parag.1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIADHESUAR NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Në funksion të mbështetjes së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, themelohet Komisioni për riintegrimin e personave të riadhesuar në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

1. **Driton Veliu**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS, kryesues
2. **Ylber Salihu**, zyrtar për integrimi evropiane, anëtar
3. **Liman Zeqiri**, shefi i zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar
4. **Arbresha Bashota**, zyrtare për shërbime sociale 1 - DSHMS, anëtare
5. **Luljeta Osmani**, zyrtare për shërbime sociale 2 - QPS, anëtare
6. **Selman Gashi**, zyrtar për çështje pedagogjike - DKA, anëtar
7. **Valmire Rekaliu**, operatore në DSHPMSh - DBF, anëtare
8. **Veton Aliu**, inxhinier - DPUMM, anëtar
9. **Blerta Plakolli**, zyrtare e lartë për kadastrë dhe gjeodezi – DPKGJ, anëtare
10. **Ahmet Ahmeti**, zyrtar i lartë për koordinimin e të drejtave të njeriut, anëtar
11. **Arzie Potera**, zyra e punësimit – APRK, dega në Podujevë - APRK, anëtare

Neni 2

Funksioni, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit sipas nenit 1, janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK) nr.22/2020 për riintegrimin e personave të riadhesuar.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për ngritjen e komisionit për integrimin e personave të riadhesuar në Komunën e Podujevës, nr.02-016-102625, i datës 09 dhjetor 2015 përfshirë edhe plotësim ndryshimet përkatëse të tij.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Arkivës

Nr. 02-020/04-0024442/21
Podujevë,
18 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Gjashtëdhjetë (60) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 6,300.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0024625/21
Podujevë, 18 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, jep këtë :

AUTORIZIM

I

Autorizohet z.Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës të nënshkruaj dokumentacionin dhe të kryej punët dhe detyrat nga kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit-DI.

II

Autorizimi jepet për shkak se Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit gjendet në trajtim shëndetësor.

III

Autorizimi vlen deri në kthimin e drejtorit të DI-së apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

Nga një kopje e Autorizimit i dërgohet:
-Të autorizuarit
-Arkivës

Nr.02-020/05-0024839/21
Podujevë, 19 mars 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim BULLIÇI





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale , përmes Thirrjes publike të dt. 03.03.2021, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta sipas Thirrjes publike të publikuar më 01.03.2021, themelohet komisioni në përbërje:

1. **Makfirete Zeka**, kryesuese, zyrtare për kujdesjen e personave me aftësi të kufizuar- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
2. **Sheribane Çitaku**, anëtare, zyrtare për çështje pedagogjike - Drejtoria e Arsimit
3. **Haxhere Ajvazi** anëtare, shefe e thesarit- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
4. **Mehmet Breznica**, anëtar- Shoqëria civile
5. **Arsim Rashiti**, anëtar-Shoqëria civile

Naxhie Hasani, zyrtare për invalid të luftës dhe familjeve të dëshmorëve-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Arkivit

Nr. 02-020/04-0024799/21
Podujevë, 19 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 68 parag. 7 të Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Ligjit të punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e kandidatëve për vendet e punës (2 vende të lira) - pozita; **Teknik/e e rentgenit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare – QKMF në Podujevë**, sipas konkursit me nr.prot.13-111/01-0012724/21 të shpallur përmes njoftimit/konkursit më 15 shkurt 2021, i ndërlidhur me afatin e aplikimit i cili fillon nga data 18 mars 2021, ngritët Komisioni, me këtë përbërje,

- | | |
|---|----------|
| 1. Bajram Bajgora , Kryeshef i mjekësisë familjare në QKMF-Podujevë, | kryesues |
| 2. Adelinë Stublla , U.D Kryeinfirmiere në QKMF - Podujevë, | anëtare |
| 3. Vjosa Krasniqi , Teknike e rentgenit në QKMF – Podujevë, | anëtare |
| 3. Jehona Havolli , Zyrtare e personelit në Komunën e Podujevës, | anëtare |
| 4. Elfete Salihu , Zyrtare për buxhet dhe financa në QKMF-Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës nr.03/L-212, Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyrës së Personelit
Anëtarëve

Nr. prot. 02-020/04-0024421/21
Podujevë,
18 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 68 parag. 7 të Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Ligjit të punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës - pozita; **Infermier/e në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare – QKMF në Podujevë**, sipas konkursit me nr.prot.13-111/01-0012724/21 të shpallur përmes njoftimit/konkursit më 15 shkurt 2021, i ndërlidhur me afatin e aplikimit i cili fillon nga data 18 mars 2021, ngritet Komisioni, me këtë përbërje,

- | | |
|--|----------|
| 1. Bajram Bajgora , Kryeshf i mjekësisë familjare në QKMF-Podujevë, | kryesues |
| 2. Adelinë Stublla , U.D. Kryeinfermiere në QKMF - Podujevë, | anëtare |
| 3. Lumnije Bici , Infermiere në QKMF- Podujevë, | anëtare |
| 4. Elfete Salihu , Zyrtare për buxhet dhe financa në QKMF-Podujevë, | anëtare |
| 5. Jehona Havolli , Zyrtare e Personelit në Komunën e Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës nr.03/L-212, Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyrës së Personelit
Anëtarëve

Nr. prot. 02-020/04-0024420/21
Podujevë,
18 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 68 paragraf 7 të Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Ligjit të punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e kandidatit për vendin e punës - pozita; **Mjek/e Specialist i biokimisë klinike në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare – QKMF në Podujevë**, sipas konkursit me nr.prot.13-111/01-0012724/21 të shpallur përmes njoftimit/konkursit më 15 shkurt 2021, i ndërlidhur me afatin e aplikimit i cili fillon nga data 18 mars 2021, ngritët Komisioni, me këtë përbërje,

- | | |
|---|----------|
| 1. Bajram Bajgora , Kryeshef i mjekësisë familjare në QKMF-Podujevë, | kryesues |
| 2. Adelinë Stublla , U.D Kryeinfermiere në QKMF - Podujevë, | anëtare |
| 3. Valbona Selmani , Teknike laborante në QKMF- Podujevë, | anëtare |
| 4. Elfete Salihu , Zyrtare për buxhet dhe financa në QKMF-Podujevë, | anëtare |
| 5. Jehona Havolli , Zyrtare e Personelit në Komunën e Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës ne.03/L-212, Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyrës së Personelit
Anëtarëve

Nr. prot. 02-020/04-0024418/21
Podujevë,
18 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 68 paragraf 7 të Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Ligjit të punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e kandidatëve për vendet e punës (9 vende të lira) - pozita; *Mjek/e specialist të mjekësisë familjare ose Mjek/e të përgjithshëm i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – QKMF në Podujevë*, sipas konkursit me nr.prot.13-111/01-0012724/21 të shpallur përmes njoftimit/konkursit më 15 shkurt 2021, i ndërlidhur me afatin e aplikimit i cili fillon nga data 18 mars 2021, ngritet Komisioni, me këtë përbërje,

- | | |
|--|----------|
| 1. Bajram Bajgora , Kryeshef i mjekësisë familjare në QKMF-Podujevë, | kryesues |
| 2. Afrim Kaçanolli , Specialist i mjekësisë familjare në QKMF-Podujevë, | anëtar |
| 3. Adelinë Stublla , U.D Kryeinfermiere në QKMF - Podujevë, | anëtare |
| 4. Elfete Salihu , Zyrtare për buxhet dhe financa në QKMF-Podujevë, | anëtare |
| 5. Jehona Havolli , Zyrtare e Personelit në Komunën e Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës nr.03/L-212, Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyrës së Personelit
Anëtarëve

Nr. prot. 02-020/04-0024417/21
Podujevë,
18 mars 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 68 parag. 7 të Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Ligjit të punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nxjerr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave dhe përzgjedhjen e kandidatëve për vendet e punës (2 vende të lira) - pozita; **Laborant/e në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare – QKMF në Podujevë**, sipas konkursit me nr.prot.13-111/01-0012724/21 të shpallur përmes njoftimit/konkursit më 15 shkurt 2021, i ndërlidhur me afatin e aplikimit i cili fillon nga data 18 mars 2021, ngritet Komisioni, me këtë përbërje,

- | | |
|---|----------|
| 1. Bajram Bajgora , Kryeshef i mjekësisë familjare në QKMF-Podujevë, | kryesues |
| 2. Adelinë Stublla , U.D Kryeinfermiere në QKMF - Podujevë, | anëtare |
| 3. Valbona Selmani , Teknike laborante në QKMF- Podujevë, | anëtare |
| 4. Elfete Salihu , Zyrtare për buxhet dhe financa në QKMF-Podujevë, | anëtare |
| 5. Jehona Havolli , Zyrtare e Personelit në Komunën e Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës nr.03/L-212, Ligjit për zyrtarët publik nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyrës së Personelit
Anëtarëve

Nr. prot. 02-020/04-0024422/21
Podujevë,
18 mars 2021

